

Kurse Trainimi ne fushen e Artizanatit

Agjencia publike “Nxitja e Biznesit Social” në bashkëpunim me Këshillin Rajonal te Kukësit shpall thirrjen për pjesmarrje në kursin e trainimit “Promovimi i punësimit dhe rritje e kapaciteteve në sektorin e artizanatit ne Kukës,Has,Tropojë”.

Ky kurs trainimi është pjese e një projektit te zbatuar nga Organizata Nderkombatare e Punës (ILO) dhe ka si qëllim:

- Promovimin e vlerave tradicionale kulturore te Artizanatit, një pjesë e të cilave janë në humbje.
- Edukimin dhe formimin profesional te brezit të ri në sektorin e Artizanatit
- Promovimin e punësimit të rinisë në fushën e Artizanatit

Kursi i Trainimit ka kohëzgjatje 6-mujore, ne fund secili pjesmarrës do te pajiset me diplomë .

Të interesuarit duhet të përmbushin këto kriteret:

- Moshë nga 15 deri 29 vjeç
- Banues në qarkun e Kukësit
- Te jenë te përkushtuar dhe të angazhohen seriozisht gjatë zhvillimit të kursit të trainimit, me listë prezencë